



2018

RAPORT-TM2-2018



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000


www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
I. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	5
1.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“	
1.1.1 Situata e furnizimit –TM2- 2018	6
1.1.2 Aktivitetet kryesore	6
1.1.3 Analizat e ujit	10
1.1.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	11
1.1.5 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	11
1.1.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	11
II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	19
2.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“	19
2.1.1 Aktivitetet kryesore- TM2- 2018	20
2.1.2 Raport i Ekipes së inspektimit dhe shqyçjes	20
2.1.3 Raport I ankesave teknike dhe komerciale	20
2.1.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	21
2.1.5 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	21
2.1.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	21
III. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIARË	18
3.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“	18
3.1.1 Aktivitetet kryesore – TM2- 2018	18
3.1.2 Arsyeshmëria e shpenzimeve	19
3.1.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	
3.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	
3.1.5 Transaksionet kryesore	
3.1.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	
IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	23
V. RAPORT I MEDIAVE	35
VI. RAPORT I ADITORIT TË BRENDSHËM	38
VII. RAPORT I ZYRËS SË PROKURIMIT	39

Anex .1	SHPENZIMET E TJERA	45
Anex .2	PROJEKTI I UJËRAVE TE ZEZA- FAZA 1 DHE 2	46
Anex. 3	PROJEKTI – EFIÇIENCA E ENERGJISË	52
Anex.3	PROJEKTI – ZONAT RURALE- FAZA E V.	59
Anex.4	ORGANOGRAMI	61

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU "HIDROREGJIONI-JUGOR" Sh.A Prizren
Mbulueshmëria me shërbime të ujësjetillësit



LEGJENDA:	
04	Zonë e shërbimit
04	Qytetet me ujë
53	Fshatrat me ujë që merrojnë nga KRU
1.38	Venbarësitë pa shërbime të ujësjetillësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

I. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

1.1 KRU „ HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN

UJI I PRODHUAR - TM1 -TM2 - 2018

TM1 - TM2 - 2018									
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN									
No.	Të dhënat	TM1- 2018		TM2-2018		NDRYSHIMI		NDRYSHIMI- %	
		l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3		
	NJËSIA P.								
1	PRIZREN	355.6	2,764,762	424.0	3,333,400	68.4	568,638.0		17.1
2	SUHAREKË	61.1	474,875	60.2	473,186	(0.9)	(1,689.0)		(0.4)
3	MALISHEVË	45.8	355,788	45.3	356,280	(0.4)	492.0		0.1
4	DRAGASH	23.3	181,195	30.3	238,463	7.0	57,268.0		24.0
5	TOTAL	485.7	3,776,620	559.8	4,401,329	74.1	624,709.0		14.2

1.1.1 SITUATA E FURNIZIMIT – TM2- 2018

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

Kompania është angazhuar dhe ka arritur që në TM-2 të vitit 2018 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (kryesisht të lagja Dardanisë dhe në lagjen 2 Korriku ku perfshihen rruga e Janinës dhe disa rrugë tjera sekondare).Për me gjëresisht është prezente tabela e reduktimeve nga Njesia Operuese ne Prizren. Sa i përket pjeses së Bazhdarhanës kryesisht banesave kolektive, jemi duke aplikuar ndryshime konform nevojës për konsum. Duhet cekur se ky ndryshim teknik është ende në provë dhe munde të kemi reduktime deri sa të finalizojmë projektin e planifikuar për ndarjen fizike të furnizimit të lagjen Dardania me lagjen Bazhdarhana, ku pas implementimit të këtij projekti lagja Bazhdarhana, lagja 2 Korriku dhe disa rrugë sekondare do të kenë furnizim të rregullt me ujë të pijes (Ky projekt është duke u financuar nga komuna e Prizrenit dhe implementimi i këtij projekti ka filluar gjatë muajit Tetor të vitit 2017).

Në njësitë tjera operuese si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes mirpo duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi aplikuar reduktime të planifikuara në varesi të defekteve të mundshme si dhe ndërprerjeve të enrgjise elektrike nga KEDS (për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njesive Operative nga udheheqsit e Njesive).

1.1.2 AKTIVITETET KRYESORE

- * Takime ditore me Kryeshefin Ekzekutiv.
- * Vizite në punishte ne te gjitha projektet te cilat jane duke u implementuar.
- * Takim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik Valdrin Lluka.
- * Takime javore në Impijant për fazen 2, në aspektin e progresit të punimeve.
- * Takim me Ulrihun.
- * Takim me ARRU-në.
- * Takim me Joerg (Konsulenca)/Prezantim: Statusi i projektit dhe vendimet e rekomanduara.
- * Takim i mëngjesit me K.Ekzekutiv-Claim nr.13 Aqualia.
- * Takim me Jeremy(Konsulenca)/Prezantim: Strategjia e llumit.
- * Takim në Prishtinë MMPH, Prezantimi i strategjisë së llumit.
- * Takim - K.K Prizren.
- * Takim në Prishtinë - K.K.
- * Takim me Konsulencen dhe me udheheqesin e zyrës për P.ZH z.Lumni Sallahu.
- * Takim zyrtar në Tiranë me kryetarin e Tiranës z.Erion Veliaj.
- * Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe banorët e fshatit Zhur.
- * Dërgimi i kërkesës për 8 punëtorë tek Enti për punësim.
- * Dërgimi i projekteve për Ujërat e Zeza në Qeverinë Japoneze.
- * Takim me Menaxhmentin lidhur me prezentimin e Impiantit tek Inkasantet dhe kontrolla.
- * Takim me Bordin.
- * Dalja dhe inspektimi i punimeve ne te gjitha projektet te cilat jane ne vijim dhe pritet te perfundojne gjate vitit 2018.
- * Dalja në teren për projektin e komunes se Mamushës.
- * Takim i rregullt mujor me kontraktoret e fazes 2 dhe konsulencen, te projektit te ujerave te zeza ne Prizren, saktesisht projekti i ndertimit te ITUZ-se.
- * Takim me konsulencen e projektit Masat Shoqeruese.
- * Projektet e financuara nge Qeveria Zviceriane dhe projektit te Eficiences se Energjise Elektrike te financuar nga KfW, raportet perkatese jane proceduar nga Menaxheret e ketyre projekteve Zenel Zenelaj dhe Aranit Ukimeri.

Prodhimi i ujit m3 - Prill-Qershor, 2018

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,333,400.00	36,630.77	424.0	
Suharekë	473,186.00	5,199.85	60.2	
Dragash	238,463.00	2,620.47	30.3	
Malishevë	356,280.00	3,915.16	45.3	
Total	4,401,329.00	48,366.25	559.8	

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Prill-Qershor, 2018

Njësia Operative	Ujësjiellësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	525	206	731
Suharekë	104	39	143
Dragash	25	08	33
Malishevë	171	71	242
Total	825	324	1,149

Zyra për planifikim dhe zhvillim – Prill - Qershor, 2018

Për periudhen që po raportojme në kuader të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në teren kanë vazhduar bllombimet e ujëmatësive nëpër qytetin e Prizren-it, ku kanë arritur këto rezultate:

- Kontrata dhe bllombime 933 kontrata.
- Konsumatorët që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 1,733 konsumator.
- Ribllombim 1,067.
- Pa ujëmatës 195.
- Kërkesa nga konsumatorët 40.
- Regjistrim i ri 29.
- Zevendesim 75.

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	933
2	Dera Mbyllur(Heren e dyte)	1,733
3	Pa ujëmatës	195
4	Ribllombim	1,067
5	Regjistrim i ri	29
6	Zevendesim	75
7	Kërkesa nga Konsumatorët	40

AKTIVITETET KRYESORE

* Përpilimi i raportit mujor si dhe TM-2, 2018.

* Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në zonar rurale”, Prizren.

* Takim pune në kshillin ndërmintoror zyra e kryeministrit për Planin e investimeve afatgjate, pjesëmarrës të gjitha KRU-të e Kosovës takimi në objektin e qeverisë së Kosovës.

* Takim pune në kshillin ndërmintoror zyra e kryeministrit për Planin e investimeve afatgjate, pjesëmarrës të gjitha KRU-të e Kosovës, takimi në KRU “Hidromorava” Gjilan.

* Takim pune në kshillin ndërmintoror zyra e kryeministrit për Planin e investimeve afatgjate, pjesëmarrës të gjitha KRU-të e Kosovës, takimi në KRU “Hidrodrini” Peje.

* Gjatë muajve Prill-Qershor grupi ka vazhduar me përpunimin e të dhënave të terrenit, vendosjen e të dhënave në GIS gjegjësisht formimin etributeve për gypa, puseta dhe pika shkarkuese ku pothuajse janë të përfunduar 100% inspektimi i kanalizimit në teren në zonën e Prizrenit dhe fshatrave si dhe vendosja e të dhënave 100 % në softwerin përkatës(QGIS).

Gjithashtu është bërë lidhja e databazës dhe hapësirës QGis me Malisheven dhe Dragashin me ç’rast inxhinjeret përkatës kanë filluar që të punojnë direkt në serverin e kompanisë që ndodhet në Prizren.

Në hapësirën QGis, janë formuar layer-at të plotësuar metribute të veta për secilin objekt me ç’rast mundeson analizimin dhe përpunimin me të lehtë në rast të ndonjë defekti ose ndonjë inspektimi të çfarodolloji.

Databaza e konfiguruar nga ana e Sherbimit Teknik dhe MMS-Tool çdo ditë bëhen backup dhe ruhen në serverin e kompanisë dhe në një Hardisk të jashtëm për rast sigurie.

Në vazhdim janë të përmendura secili objekt që është i vendosur në Qgis.

1. Formularët për çdo pusete në formë elektronike dhe hardcopy
2. Tabela etributeve për gypa të kanalizimit
3. Tabela etributeve për puseta të kanalizimit
4. Tabela etributeve pikat shkarkuese
5. Struktura e bazës së të dhënave
6. Defektet apo urdheresat e punëve për çdo objekt

Gjithashtu ka filluar edhe matja e pusetave me GPS në qytetin e Prizrenit ku janë përfunduar 95% të matjeve.

Në këtë muaj kemi filluar edhe testimin e MMT (Maintenance Management Tool) apo aplikacioni për të regjistruar urdheresat e punës ku ka filluar përdorimi mirpo si fazë testuese nga Departamenti i Operativës.

Keto të dhëna janë strukturuar në databazën e konfiguruar në serverin e kompanisë ku secilit përdorues të GIS-it ju është mundësuar qasja në databazë Postgis si dhe në hapësirën punuese QGIS, keto dy hapësira janë të ndërlidhura mes vete gjë që ka mundësuar përfshirjen e shumë përdoruesve në të njëjtën kohë.

* Kontrollimi i D.B, refreshimi i rekordeve në D.B, regjistrimi i rekordëve të reja në D.B, futja e të dhënave në D.B, përpunimi i të dhënave të grupit të kanalizimit në gjendje grafike (exel) nga terreni në Prizreni dhe fshatrat si dhe përgaditja dhe printimi i formularve për teren.

* Në muajt Prill - Qershor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 319 ujëmatës, ekziston raporti i veçant si dhe lexim të ujëmatësave.

* Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Prill-Qershor, ka bërë gjithësej 192 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 137 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 7,882 m.

* Leximi i ujëmatësave zonal për muajt Prill-Qershor, ujëmatësat në pikat matëse: Të KFORI, Jusuf Gervalla dhe Atmaxhë kemi lexim të ulët (Atmaxhë Baypass), Kojush II dhe Gjonaj i poshtem i kemi ujëmatësat e demtuar (xhami i ujëmatësit dhe koka e ujëmatësit), Nashec i epërm dhe Tupec i kemi pusetat me ujë si dhe Landovicë nuk kemi lexim të ujëmatësit. Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt gjatë këtyre muajve.

Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: Prill-Qershor, 2018

Ky shërbim bënë servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili \emptyset mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	89	
	3/4"	294	
	1"	33	
	5/4"	00	
	6/4"	01	
	Gjithsejt:	417	
Suharekë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	5/4"	00	
	Gjithsejt:	00	
Dragash	1/2"	12	
	3/4"	29	
	1"	03	
	Gjithsejt:	44	
Malishevë	1/2"	01	
	3/4"	13	
	1"	00	
	Gjithsejt:	14	

Totali: 475 copa

- Leximi i ujëmatësave 2 herë në muaj.
- 02 Ekspertiza

1.1.3 Analizat e ujit – TM2- 2018

Sherbimi i perpunimit dhe kontrollit te kualitetit te ujit
Laboratori i” Hidroregjionit Jugor “ Prizren

Aktivite tjera:

Kontrolli i Klorit residual ne te gjitha pikat e furnizimit, kontrolli i paisjeve dhe procesit te Klorifikimit ne stacionet e Klorifikimit si dhe kontrolli i rregullt i BURIMEVE dhe sasis se ujit.

Furnizimi i perhershem i zonave Rurale me Hipoklorit Natriumi. Marrja e mostrave sipas Planit te MONITORIMIT ne kroje te qytetit dhe zona rurale si ne njesi ashtu edhe ne regjion si dhe ne Burime. Ne objektin e Kalas ishim per kontroll dhe pam se ishin vendosur dy kontenier nga puntoret qe punojn ne kala ne menyre te pa ligjeshme mbi rezervuar ua terhoqem verejtjen dhe se bashku me zyrtsrin per siguri te objekteve dhe inspektorin komunal i larguam nga aty.

Ne Kabash te hasit bem monitorimin e aparatit te klorifikimit ne objektin e ri.

Ne Samadraxhe ne stacionin e dozimit mbajtem nje TRAJNIM se si behet dozimi adekuat dhe menyra e matjes se klorit residual ne rrjet me aparaturat e reja. Ne Dragash ishim disa her per takime pune dhe udhezime ne lidhje me hapat qe duhet ndermarr si njesi per sanimin e problemeve me te cilat po ballafaqoheshin. Ne Prishtin ishim ne takim pune ne Hotel”Afa” me temen mbi Kualiteti i ujit te pijes. Vizit e nje delegacioni nga CDI ne Laboratorin ton me z,Hajrije Morina. Evitimi i nje defekti ne stacionin e klorifikimit ne Zhur. Riparimi i sistemit te klorifikimit ne fshatin Serbic e Ulet dhe marrja e mostre (Riperseritje) Ripartimi i sistemit te klorifikimit ne “Bunar-1” disa pjes fazonike per injektorin per Kala. Riparimi i sistemit te klorifikimit ne “Mullirin e vjeter” gypin e injektorit ne fi 600. Po te “Mulliri i vjeter” bem nderrimin e injektorit ne fi 400 me nje injector te ri. Ne Prishtin te :ERA-MED” u furnizuam me Komparator dhe tablet DPD-1 . Pjesmarrja ne 2 puntori ne SHUKOS per Menaxheret e Cilesis se ujit.

Analizat Bakteriologjike Laboratori “Hidroregjioni Jugor “ Prizren _Prill, Maj, Qershor - 2018

Njesia	Lloji i ujit	Nr.i mostrave	Nr.i Mostrave qe nuk pergjigjen
Prizren	Burim	9	0
	Ujesjelles	54	1 (Seric e ujt)
Suhareke	Burim	1	0
	Ujesjelles	11	1 (Samadraxhë)
Dragash	Burim	4	0
	Ujesjelles	7	0
Malisheve	Burim	0	0
	Ujesjelles	7	2 (Malishevë)
Totali		93	4

Analizat Bakteriologjike, ISHP - Prizren Prill-Qershor/2018

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	08*	08*
	Ujësjetllës	204	00
Suharekë	Burim	02	02*
	Ujësjetllës	28	00
Dragash	Burim	02*	02*
	Ujësjetllës	10	00
Malishevë	Burim	00	00
	Ujësjetllës	27	00
Totali		281	12*

Numrin total i analizave në ujësjetllës 269 dhe të gjitha i përgjigjen standardeve.

1.1.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

1.1.5 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Te gjitha defektet ne sistem te ujesjetllesit dhe kanalizimit jane sanuar me kohe,
- Eshte percjell ne menyre permanente cilesia e ujit te pijes ne nivel regional,
- Eshte pergaditur dhe miratuar strategjia e UPF-se.

1.1.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me uje te pijes ne gjith zonen e sherbimit
- Monitorimi i cilesise se ujit te pijes ne nivel regjional,
- Vazhdimi i analizes se rrejtit te ujesjetllesit dhe bartja e te dhenave ne GIS,
- Fillimi i implementimit te strategjise per uljen e UPF-se

*Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.

- Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjetllesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
- Senzibilizimin e te gjithe konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
- Ngritjen e vetedijes te te gjithe konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

II. RSPORT NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATOR

2.1 K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN

2.1.1 Aktivitetet kryesore- TM2-2018

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA

TM1- TM2 -2018

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

TM1- TM2 - 2018- CAQET			
No.	Të dhënat	TM1-2018	TM2 - 018
1	Shtëpiak	40,670	41,033
2	Ndryshimi		363
3	Ndryshimi në %		0.89%
4	Kome.-Indu.	5,618	5,646
5	Ndryshimi		28
6	Ndryshimi në %		0.5
7	Institucional	296	298
8	Ndryshimi		2
9	Ndryshimi në %		0.7
10	TOTAL	46,584	46,977
11	Ndryshimi		393
12	Ndryshimi në %		0.84%

AKTIVITETET KRYESORE

- Në raport me TM2 2018 kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i legalizimit dhe pëlqimeve mbrenda zonës së shërbimit.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Në shumë raste konsumatorët kyqen në rrjet të ujesjellsit dhe kanalizimit pa pëlqime paraprake , ku pas kyqjes duhet ti legalizojm bazuar në procedurat e mbrendshme të Kompanisë.

MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK

- Regjistrimi dhe legalizimi i secilit konsumatorë I cili është kyq në rrjet
- Pamundësia e zbulimit dhe regjistrimit të secilit konsumatorë të kyqur në rrjet

MASAT E PROPOZUARA

- Inspektime më të shpeshta në teren dhe zbulim të menjëhershëm të rasteve të cilat veq janë kyq në rrjet

FATURIMI - m³**TM1 - TM2 -2018****K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN**

TM1-TM2 -2018			
No.	Tëdhënat	TM1- 2018	TM2- 2018
1	Shtëpiak	1,349,355	1,578,999
2	Ndryshimi	-	229,644
3	Ndry. %	-	17.0
4	Kome.-Indu.	138,859	174,529
5	Ndryshimi	-	35,670
6	Ndry. %	-	25.7
7	Institucional	129,519	134,761
8	Ndryshimi	-	5,242
9	Ndry. %	-	4.0
10	TOTAL	1,617,733	1,888,289
11	Ndryshimi		270,556
12	Ndry. %		16.7%

AKTIVITETET KRYESORE

- Në raport me TM1 2018 kemi një faturim më të madh të ujit të faturuar në m³ në krahasim , gjë që është e natyrshme kur kemi parasyshë sezonën verore gjatë këtij TM dhe rrjedhimisht edhe konsumi është më të madh.
- Në raport me TM1 kemi nje rritje te faturimitnë m³ si rezultat i rritjes së konsumit nga konsumatorët.

2.1.2 RAPORT I EKIPES SË INSPEKTIMIT DHE SHKYÇJES- TM2-2018

Njesia Operative	Lidhjet e reja/legalizime	Shkyçjet	Lidhje jasht ores	Proceverbale per borxhe/shkyçje	Verifikimi i ujëmatësve
Prizren	338	28	28	2,958	652
Suharekë	67	7	7	134	1,338
Malishevë	66	7	4	50	279
Dragash	5	1	1	21	24
KRU "Hidroregjioni Jugor"	476	43	40	3,163	2,293

2.1.3 RAPORT I ANKESAVE TEKNIKE DHE KOMERCIALE

ANKESAT TEKNIKE

NR	Njesite Punuese				
	Muaji	Prizren	Suharekë	Malishevë	Dragash
1	Prill	122	38	8	12
2	Maj	128	37	5	8
3	Qershor	123	0	5	3
4	TOTAL	373	75	18	23

ANKESAT KOMERCIALE

NR.	Njesite Punuese				
	Muaji	Prizren	Suharekë	Malishevë	Dragash
1	Prill	35	35	7	0
2	Maj	39	37	5	0
3	Qershor	49	0	13	0
4	TOTAL	123	72	25	0

2.1.4 PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Edhe pse kemi rritje të numrit të konsumatorëve , trendi i rritjes së faturimit nuk është i kënaqshëm për këto arsye:
Pamundësia e rritjes së shërbimeve në zonat rurale sipas planifikimit.
Edhe pse kemi një rritje graduale të numrit të konsumatorëve, emigrimi i popullsisë po ndikon në rënie të konsumit të konsumatorët e amvisërisë. Është shqetësues fakti që familje të tëra, mbyllin dyert e shtëpive dhe banesave dhe mbrenda një periudhe nuk jetojnë aty. Me këtë rast ne faturojm vetëm tarifën fikse të këto raste.
- Problem paraqet edhe leximi korrekt i ujëmatësve për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të konsumatorëve, ashtu që inkasatët nuk po arrijnë që të mbulojnë terrenin, pasi që janë të angazhuar edhe në inkasim dhe në lexim.
- Shfrytëzimi i paautorizuar i ujit nga konsumatorët (by pass) jashtë orës.

2.1.5 MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK

- Kemi bërë përpjekje që të reduktojmë sa më shumë humbjet teknike dhe komerciale
- Leximi dhe faturimi i saktë i konsumit të ujit .
- Nuk kemi arritur që t'i marrim në menagjim fshatrat e reja.

2.1.6 MASAT E PROPOZUARA

- Reduktimi i sa më shumë humbjeve komerciale, leximi më korrekt në kohë nga ana e inkasatëve
- Leximi dhe faturimi i saktë i konsumit të ujit .
- Mbulimi i terrenit edhe përmes kontrollorëve aty ku nuk arrijnë inkasatët

FATURIMI - €
TM1 - TM2 -2018
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

TM1-TM2 -2018					
No.	Tëdhënat	TM1- 2018	TM2- 2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI- %
1	Faturimi-€	960,071.16	1,096,123.63	136,052.47	14.2%
2	Total- Shte.	705,358.43	805,405.72	100,047.29	14.2%
3	Ndryshimi				
4	Ndry. %				
5	Total- kome.	148,131.01	177,698.61	29,567.60	20.0%
6	Ndryshimi				
7	Ndry. %				
8	Total-Inst.	106,581.72	113,019.30	6,437.58	6.0%
9	Ndryshimi				
10	Ndry. %				
11	Tetjera	16,355.10	16,030.30	(324.80)	-2.0%
12	Total	976,426.26	1,112,153.93	135,727.67	13.9%

AKTIVITETET KRYESORE

- Në TM2 2018 kemi një faturim më të madh shprehur në vlerën euro , në krahasim me TM1 2017 për këto arsye:
 - faturimi më i madh në m³ ka reflektu edhe në rritje në euro
 - në amvisëri kemi rritje të faturimit në euro si rezultat i rritjes së tarifës në amvisëri
 - te bizneset dhe institucionet rënia e tarifës fikse dhe volumetrike ka ndiku edhe në zvoglim të faturimit në euro

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Vështirësi në leximin e ujëmatësve për shkak të një numri të madh të pusetave të pa përshtatshme për lexim.
- Pamundësia e mbulimit të të gjithë konsumatorëve në leximin e rregullt të ujëmatësve.
- Numri i madh i konsumatorëve në raport me Inkasantët që i kemi në teren.

MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK

- Leximi i ujëmatësve
- Shpërndarja e faturave te konsumatorët

MASAT E PROPOZUARA

- Inkurajimi i Inkasantëve në leximin sa më korrekt të ujëmatësve
- Ofrimi i përkrahjes edhe nga punonjësit tjerë të njësisë në raste të veqanta kur nuk mund të bëhet leximi vetëm nga Inkasanti.
- Shtimi i numrit të Inkasantëve krahas rritjes së numrit të konsumatorëve dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.

ARKËTIMI -€**TM1 - TM2 -2018****K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN**

TM1 - TM2 -2018					
No.	Tëdhënat	TM1- 2018	TM2- 2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI- %
1	Total- Shtëpiak	665,217.96	676,703.14	11,485.18	1.73%
2	Ndryshimi		11,485.18		
3	Ndry. %		1.7%		
4	Total-Komercial-Industrial	111,404.27	143,795.94	32,391.67	29.08%
5	Ndryshimi		32,391.67		
6	Ndry. %		29.1%		
7	Total Institucional	103,054.04	111,226.92	8,172.88	7.93%
8	Ndryshimi		8,172.88		
9	Ndry. %		7.9%		
10	Total - ujë	879,676.27	931,726.00	52,049.73	5.92%
11	Ndryshimi		52,049.73	(879,676.27)	
12	Ndry. %		5.9%		
13	Tetjera	7,567.97	13,654.88	6,086.91	80.43%
14	Ndryshimi		6,086.91		
15	Ndry. %		80.4%		
16	TOTAL	887,244.24	945,380.88	58,136.64	6.55%

AKTIVITETET KRYESORE

- Arkëtimi në raport me TM1 2018 ka pësuar rritje pasi që në gjatë TM2 2018 janë shtuar aktivitetet e stafit të Shërbimit me Konsumatorë.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Si zakonisht, problemet kryesore në këtë aspekt janë mos gadishmëria e qytetarëve për të kryerë obligimet ndaj Kompanisë.
- Pamundësia e sigurimit të numrave personal të konsumatorëve, numra të cilët i kërkon përmbaruesi gjatë zhvillimit të procedurave të përmbarimit.
- Emri i konsumatorit i cili figuron në bazën e konsumatorëve, në shumë raste është kryefamiljar i cili ka vdekur dhe borxhet veq po parashkruhen.

MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK

- Angazhimi i inkasantëve dhe inspektorëve në arkëtimin e mjeteve.

MASAT E PROPOZUARA

- Vazhdimi dhe rritja e intensitetit të punës së ekipeve të inspektoratit dhe inkasantëve në inkasim të mjeteve
- Përkushtimi i vazhdueshëm i inkasantëve dhe inspektoratit në leximin dhe faturimin sa më korrekt të konsumatorëve si dhe insistimin në arkëtimin e mjeteve.

III. KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR FINANCIAR

3.1 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

3.1.1 AKTIVITETET KRYESORE – TM2 2018

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

- Regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe asetëve për muajt përkatës.
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Prgatitja e raporteve mujore, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe pregatitja e pagave për muajtë përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrimit të të punsuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Plotesimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas formës standerte të kërkuar nga ATK, për muajtë përkatës;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Në këtë tre mujor kemi pas edhe përmbylljen e pasqyrave financiare si dhe raportin e auditorëve të jashtëm për vitin fiskal 2017.

3.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

SHPENZIMET - €

TM1 - TM2 -2018					
No.	Tëdhënat	TM1- 2018	TM2- 2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI- %
1	Total Shpenzimet Operative	878,822.28	859,473.75	(19,348.53)	-2.2%
2	Ndryshimi	-	(19,348.53)		
3	Ndryshimi ne %	-	-2.20%		
4	Pagat	499,964.12	497,351.16	(2,612.96)	-0.5%
5	Energjiaelektrike	203,782.44	207,859.77	4,077.33	2.0%
6	Shpenzimet e derivateve	20,199.74	17,922.43	(2,277.31)	-11.3%
7	Mirëmbajtjadheriparimet	77,657.73	50,387.00	(27,270.73)	-35.1%
8	Mirëmbajtja e automjeteve	9,176.59	6,411.87	(2,764.72)	-30.1%
9	Shpenzimet e taksave	18,479.24	22,690.75	4,211.51	22.8%
10	Kemikalet	3,531.21	2,946.81	(584.40)	-16.5%
11	Shpenzimettjera	46,031.21	53,903.96	7,872.75	17.1%

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e II-të 2018, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të I-rë 2018, janë më të ulta, kjo ka ndikuar edhe në performancën më të mirë për këtë tremujor.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo uljes së tyre;

Pozicioni i shpenzimeve të pagave, në këtë pozicion, kemi një rënje të lehtë të shpenzimeve, sidomos në Njësinë e Suharekës dhe Malishevës, edhe pse numri i punëtorëve është pothuaj se i njëjtë, po shtesat kanë qenë më të ulëta;

Ndërsa te pozicioni i energjisë elektrike, kemi një rritje të lehtë të shpenzimeve në krahasim me tremujorin e I-rë. Me fillimin e sezonit veror, rritet edhe konsumi i ujit, kjo ndikon direkt edhe në rritjen e shpenzimeve të energjisë;

Te pozicioni i derivateve nuk kemi ndonjë ndryshim të shpenzimeve, me një ulje të vogël, por që nuk ka aspak ndikim në shpenzime totale;

Ndërsa, te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi një rënje të konsiderueshme të shpenzimeve në krahasim me tremujorin e kaluar. Këto shpenzime varen nga shumë faktorë, si ndërhyrjet në rrjet, mirëmbajtjet e pompave etj, pra ky është një nga pozicionet që ka ndikuar edhe në rënjen totale të shpenzimeve;

Por te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve kemi rënje të këtyre shpenzimeve, pasi mirëmbajtja e tyre ka qenë më pak e nevojshme në këtë tremujor;

Shpenzimet e taksave janë më të larta, në krahasim me tremujorin e kaluar, pasi që shpenzimet për taksat e përmbaruesit kanë qenë më të mëdha, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njëjta;

Edhe te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e dhuratave për punëtor etj, kemi rritje të këtyre shpenzimeve, por që nuk kanë ndikuar shumë në rritje të shpenzimeve totale;

Pra si përfundim, shpenzimet për këtë tremujor kanë qenë më të ulëta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura me lartë.

3.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

3.1.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

3.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

3.1.6 TRANSAKSIONET KRYESORE GJATË TM2-2018

Nëse nisemi nga inkasimi gjatë periudhës së tremujorit të dytë, inkasimet kryesore ose që mbushin arken e kompanisë janë pothuaj se të gjitha nën vlerën 1,000 €, ndërsa pjesa më e vogël e inkasimit që është mbi 1,000 €

Transaksione të mëdha, mjete të cilat kanë hyrë në llogaritë tona bankare kemi edhe nga MMPH; 250,390.19 €, 5,3424.49 € dhe 318,751.68 €, por që janë mjete të lëshuar për projektin e ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza. Ku më pas të gjitha këto mjete transferohen në llogarinë e punëkryesit.

Ndër transaksionet/daljet më të mëdha për këtë periudhë kemi, pra ndaj punëkryesit të janë mjetet e lëshuara nga organizatat buxhetore. Nga këto e kemi Komunën e Prizrenit, ku transaksionet e tyre për muaj janë mbi 8,000 €, ku përfshihen krojet publike, drejtoritë perkatesë të komunës etj.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe transaksione më të madhe kemi edhe Abi&Elif, 4,073.94 €, 2,530.11 € varësisht nga shpenzimet mujore; Qendren e paraburgimit 1,778.83 €; Hotel Abi 7,066.97 €

Impiantit, tani kemi ndaj Rai Commerce – 40,000.00 € punëkryesit të projektit të shtrirjesë së gypave nga 40 burimet deri te hyrja në qytet (Lidhja e Prizrenit); kemi ndaj kompanisë Burimi-Com – 26, 334.75 € shpimi i puseve në Mushtisht, kemi Xërxën për furnizimet me material fazonik mbi 40 DN – 20,415.00 € dhe 20,000.00 €; gjithashtu edhe Endriti për furnizim me material fazonik nën 40 DN – 15,376.80 €. Këto ishin disa nga transaksionet më të mëdha, por kemi edhe dalje të tjera mujore, siç është ARRU 4,161.37 €; Petrol Company 7,716.00 € e varësisht nga shpenzimet mujore për derivate.

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS**TM1 - TM2 -2018****K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN**

Treguesit e Performancës	[Njesia]	TM1-TM2 -2018		
		TM1-2018	TM2 - 2018	NDRYSHIMI
Uje i faturuar-si perqindje	%	42.84%	42.90%	0.001
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	57.16%	57.10%	-0.0006
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	91.63	85.00	-6.62
Norma e arketimit - Amviserite	%	94.31	84.02	-10.29
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	75.21	80.92	5.71
Norma e arketimit -Institucional	%	96.69	98.41	1.72
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.01	1.10	0.09
Staf per 1000 konsumatore	numer	7.04	7.02	-0.02
		TM1	TM2	TM1+TM2
		8,422.00 €	85,907.00€	94,329.00 €

AKTIVITETET KRYESORE

- Te norma e pergjithshme e arketimit kemi nje renie ne perqindje , pasi qe ne TM2 2018 kemi rritje të faturimit dhe njëkohësisht edhe rritje ne inkasim. Mirepo, raporti ne mes shumës së faturuar dhe shumës së inkasuar jep përqindje më të vogel në inkasim.

PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN E CAQEVE

- Rritja e vazhdueshme e konsumatorvëe në terrenet e inkasantëve po e pamundëson që të vizitohet secili konsumatorë disa herë mbrenda muajit (ne rastet kur konsumatori nuk gjendet në shtepi në kohën kur vizitohet nga inkasanti).
- Mospërmbajtja e kontratës për riprogramim nga ana e disa konsumatoreve
- Mospagesa e faturave rrjedheve nga konsumatoret

MASAT E REALIZUARA / MOSREALIZUARA NGA TM PARAPRAK

- Angazhimi i të gjithë stafit të njësisë në realizimin e detyrave të punës me sa më shumë përgjegjësi dhe kompetencë, në mënyrë që të përmirësojmë cilësinë e shërbimeve ndaj konsumatorëve.
- Rritja e numrit të konsumatoreve të cilet vizitohen nga ekipet e inspektoratit

MASAT E PROPOZUARA

- Intensifikim i aktiviteteve në rritjen e treguesve të performances
- Rritja e numrit të konsumatorëve për pagesa dhe riprogramim të borxheve

IV RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marruar me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta në lëmin e veprimtarisë së Kompanisë.
- Pas vlerësimit të punës së punonjësve nga udhëheqësit e shërbimeve përkatëse janë vazhduar kontratat e punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qenë në kohë të caktuar, si dhe të punëtorëve që kanë pasur kontratën e parë të punës me mundësi të vazhdimin.
- Gjatë këtij tre mujori 19 punëtorë kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor, 143 kanë qenë në pushim vjetor, vazhdojnë të jene në pushim të lehonisë dy (2) punëtorë. Një punëtorë i njësisë punuese të Suharekës pas shfrytëzimit të pushimit mjekësor me pagesë 100% nga lëndimi në punë ishte në kompensim të pushimit mjekësor me 70% të pagesë nga data 28.05.2018 deri 25.06.2018 si dhe dy punëtorë janë duke shfrytëzuar pushimin pa pagesë, njëri i njësisë punuese të Prizrenit dhe një i njësisë punuese të Malishevës.
- Është bërë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje e duhur në azhurnimin e rregullt të ueb-faqes, siç parashihet me Ligj mbi NP, janë kryer të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetin përkatës sipas ligjit.
- Gjithashtu ky shërbim ka lëshuar për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje dhe pranimit teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga donacionet sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Në mbështetje të nenit 56 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212 , për punonjësit është bërë kompensimi i punës jashtë orarit me ditë pushimi.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimit apo pëlqimit nga udhëheqësit e tyre i drejtpërdrejtë.
- Janë përgatitur dhe shpallur në shtypin ditorë 5 (pesë) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë, një nga konkuret e shpallura është anuluar për shkak se kandidatët që kanë aplikuar nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit. Konkursi i anuluar është rishpallë me datë 20.06.2018. Shpallja e konkurseve është bërë pas konfirmimit me shkrim nga shërbimi i financave se Kompania posedon buxhet të mjaftueshëm për shpallje të konkurseve publike sipas Ligjit të Punës.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Auditori i Brendshëm, lënda e auditimit ka qenë lidhur me menaxhimin e procesit të rekrutimit të punonjësve, të zhvilluar gjatë periudhës kohore 31.07.2017 deri më 31.03.2018.
- Punëtori B. Aljimi nga pozita e punës **-Kujdestar- Rojtar në 40 Burime**, ka kalua në pozitën e punë **Mirëmbajtës i pompave** ky ndërrim i pozitës është bërë pas kërkesës se bërë nga

Udhëheqësi i njësisë punuese Prizrenit dhe kërkesë kjo e aprovuar nga KE dhe ZLF, pastaj nga Zyrtarja për Burime Njerzore është bere vendimi dhe kontrata.

- Punëtori Z. Fanaj Nga pozita e punës **Rojtar ne objektin Ortakoll** ka kalua ne pozitën e punës **Inkasant**, ndërsa punëtori Rexhep Hajdari nga pozita e punës **Inkasant** ka kalua ne pozitën e punës **Rojtar ne objektin Ortakoll**. Këto ndërrime te pozitave janë bere ne baze te kërkesës se Menaxherit Rajonal per Konsumator dhe aprovimit nga **KE** dhe **ZLF**.
- I është shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me shkrim të punësuarit Z. J i sistemuar në punë dhe detyra të punës Kujdestar-rojtar te bunari 1, në njësinë punuese të Prizrenit , për shkak të shkëljes së detyrave të punës.
- Është përgatitur kërkesë për riorganizim të NP- KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A në Prizren dhe KRU" Gjakova"Sh. A në Gjakovë dhe është drejtuar ne Kuvend të kosovës dhe në Ministrinë përkatëse të Qeverisë.
- Është dërguar në NJPMNP sipas kërkesë Lista me të dhënat e kohëzgjatjes së kontratave të punës për zyrtarët e lartë të kompanisë.
- Janë dërguar në NJPMNP Përgjigjet në pyetjet e kërkuara nga Drejtori i NJPMNP shtesë, te cilat kanë të bëjnë me projektin e Komisionit Evropian "Projekti i Vlerësimit të Rreziqeve në Qeverisje në Ballkanin Perëndimor – GRASP".

Konkurset: Prill - Qershor-2018

1	Inkasant	1	04.05.2018
2	Punëtor fizik	4	08.05.2018
3	Inkasant anuluar 12.06.2018	1	15.05.2018
4	Vozitës i mjeteve të punës (M,L,T),	1	07.06.2018
5	Rishpallje Inkasant	1	20.06.2018

PERSONELI – PRILL – QERSHOR 2018

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Prill	323		2	1	
Maj	322				
Qershor	322			1	

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: QERSHOR - 2018

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH. A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	276	34	5	7	322

Numri i Punëtorëve në %	85.7	10.6	1.6	2.2	100
-------------------------	------	------	-----	-----	------------

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	41	12.73	
MESHKUJ:	281	87.27	
TOTAL	322	100.00	

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: QERSHOR 2018

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
KUALIFIKIMI								
DHJETOR	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	32	36	1	205	1	46	1	322
Kualifikimi në %	9.94	11.18	0.31	63.66	0.31	14.29	0.31	100

Raport i numrit te punetoreve, Prill- Qershor – 2018

Nr	Muaji	Hidroregjion i Jugor	Prizren			Suharekë	Dragash	Malishe -vë
			Prizren	Bordi	Total			
4	Prill	329	235	6	241	37	17	34
5	Maj	328	235	6	241	36	17	34
6	Qershor	328	233	6	239	38	17	34

PËRFAQËSIMI NË GJYKATA DHE ARDHJA NË TOTAL E LËNDVE NGA GJYKATAT PËR PERIU DHËN KOHORE PRILL – QERSHOR 2018

Muaji	Seanca përgatit ore	Seanca kryesor e	Seanca të shtyra	Shkresa te ardhura nga gjykatat
Prill	3	2	1	12
Maj	4	4	3	15
Qershor	/	2	1	7

Totali	7	8	5	34
---------------	----------	----------	----------	-----------

Siç edhe shihet në tabelën lart, në këtë periudhë kohore kemi marrë pjesë në gjithsej **20 (njëzet)** seanca gjyqësore prej të cilave **7 (shtatë)** seanca kanë qenë përgatitore, **8 (tetë)** seanca kryesore dhe **5 (pesë)** seanca për arsye objektive janë shtyrë dhe do të caktohen data të tjera për shqyrtim.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018, në Zyrën Ligjore nga Gjykatat kanë ardhur këto shkresa:

- **1 (një)** Aktgjykim në favor të Kompanisë;
- **Nuk ka pas** Aktgjykim kundër Kompanisë;
- **Për 5 (pesë)** lëndë nga gjykatat janë marrë Aktvendime në favor të kompanisë;
- **Për 8 (tetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë Aktvendime kundër kompanisë;
- **Për 5 (shtatë)** lëndë gjykatat kanë aprovuar pjesërisht Prapësimet e konsumatorëve;
- **1 (një)** Konkluzion me të cilin gjykata na njofton se pala në procedurë ka vdekur;
- **1 (një)** Konkluzion me të cilin gjykata cakton përfaqësues të përkohshëm pasi që pala ka vdekur;
- **Nuk ka pasur** Konkluzione;
- **Nuk ka pasur** Njoftime nga Gjykata dhe institucione tjera
- **7 (shtatë)** Thirrje për seanca gjyqësore;
- **2 (dy)** Padi është ushtruar kundër Kompanisë sonë;
- **2 (dy)** Përgjigje në Padi është dhënë nga Kompania jonë;
- **Nuk ka pasur** Ankesa në Gjykatën e Apelit i kanë parashtruar konsumatorët kundër Vendimeve të gjykatave;
- **Nuk ka pasur** Kërkesë nga një konsumatorë i cili ka kërkuar që ti fshihet borxhi nga Kartela e klientit;
- **1 (një)** Ekspertizë në favor të Kompanisë;
- **Nuk ka pasur** Ekspertizë kundër Kompanisë;

- **1 (një)** Ujdi gjyqësore;
- **Nuk ka pasur** Urdhëresë për pagesë të garancisë apo taksave të ndryshme;
- Nga Gjykatat në total kanë ardhur **34 (tridhjetë e katër)** shkresa.

PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT PRILL – QERSHOR 2018 NJËSIA PUNUESE PRIZREN

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Prill	17	/	/	2	/	1
Maj	107	6	6	8	1	3
Qershor	110	5	5	14	/	2
Totali	234	11	11	24	1	6

Nga Njësia Punuese e Prizrenit me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **234 (dyqindtë e tridhjetë e katër)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **11 (njëmbëdhjetë)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **11 (njëmbëdhjetë)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **24 (njëzet e katër)** marrëveshje me debitorë.
- **1 (një)** lëndë e tërhequr.
- Janë përfunduar **(gjashtë)** lëndë.

PRILL – QERSHOR 2018 NJËSIA PUNUESE MALISHEVË

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Prill	/	/	/	5	1	7
Maj	/	/	/	2	/	9
Qershor	10	/	/	4	/	2
Totali	10	/	/	11	1	18

Nga Njësia Punuese e Malishevës me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **10 (dhjetë)** lëndë me propozim për përbarim.

- **Nuk ka pasur** propësime.
- **Nuk ka pasur** përgjigje në propësime.
- Janë lidhur **11 (njëmbëdhjetë)** marrëveshje me debitorë.
- Është tërhequr **1 (një)** lëndë.
- Janë përfunduar **18 (tetëmbëdhjetë)** lëndë.

PRILL – QERSHOR 2018 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në propësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Prill	13	2	2	6	/	2
Maj	/	1	1	6	/	11
Qershor	8	1	1	4	/	3
Totali	21	4	4	16	/	16

Nga Njësia Punuese e Suharekës me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **21 (njëzet e një)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **4 (katër)** propësime.
- Nga kompania janë dhënë **4 (katër)** përgjigje në propësime.
- Janë lidhur **16 (gjashtëmbëdhjetë)** marrëveshje me debitorë.
- Nuk ka pasur lëndë të tërhequra.
- Janë përfunduar **16 (gjashtëmbëdhjetë)** lëndë.

PRILL – QERSHOR 2018 NJËSIA PUNUESE DRAGASH

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në propësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Prill	/	/	/	/	/	/
Maj	17	/	/	/	/	/
Qershor	/	2	2	/	/	/
Totali	17	2	2	/	/	/

Nga Njësia Punuese e Dragashit me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë për këtë tremujorë janë dërguar **17 (shtatëmbëdhjetë)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **2 (dy)** propësime.
- Nga kompania janë dhënë **2 (dy)** përgjigje në propësime.
- **Nuk ka pasur** asnjë marrëveshje me debitorë, tërheqje të ndonjë lënde dhe lëndë të përfunduara.

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vlera	Vërejtje
1.	C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Ende e pacaktuar	Lënda gjendet në gjykatën e Apelit në Prishtinë
2.	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në gjykatën e Apelit në Prishtinë
3.	C. nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në gjykatën e Apelit në Prishtinë

1. **C. nr. 1214/12, datë 05.03.2013**, Padi për kthim në vendin e punës, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, lënda gjendet në gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.
2. **C. nr. 116/03, datë 08.05.2013**, Padi për kompensim dëmi, dëmshpërblimi ende nuk është i caktuar, lënda gjendet në gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.
3. **C. nr. 286/14, datë 03.06.2015**, Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës, Dëmshpërblimi ende i pacaktuar, Lënda gjendet në gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Aktivite e Zyrarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë TM-2 / 2018

Në tremujorin e dytë janë realizuar vizitat e objekteve të Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, janë vizituar të gjitha objektet në njësinë e Prizrenit, siç janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatore”, objektet te “Mulliri i vjetër”, objektet e “40 Burimet”, objekti dhe “40 Burimeve - II “ ku janë kontrolluar gjendja e tyre, pastërtia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapësira për rreth objekteve, si dhe është bërë kontrollimi dhe sistemimi i aparateve kundër zjarrit.

Gjatë vizitës rezervarëve në hapësirën e kalasë të Prizrenit kemi vërejtur se ka pasur të vendosur objekte mbi rezervarë nga ana e Institutit për mbrojtjen e monumenteve historike të kalasë së Prizrenit, prandaj në bazë përgjegjësi kemi reaguuar duke bërë shkresë zyrtare Inspektoratit të Komunës, kemi dalë së bashku në vend ngjarje dhe janë larguar menjëherë objektet të vendosura mbi rezervuar të ujit të pijes.

Është bërë Kontrollimi i objekteve të Kompanisë duke i kontrolluar të gjitha aparatet kundër zjarrit, gjendjen e tyre si dhe janë kontrolluar hidrantët e ujit në kompani si dhe në objektin e vjetër të kompanisë .

Në këtë tremujor është bërë servisimi i aparateve kundër zjarrit për të gjitha njësit punuese të “Hidroregjionit Jugor” me firmën kontraktuese sipas kontratës.

Në këtë periudhë është realizuar një test-trajnim për lëmin e sigurisë dhe shëndetin në punë, testi është organizuar nga kompania e specializuar për siguri dhe shëndet në punë HSK llc Prishtinë.

Kërkesë për furnizimin me kutia të ndihmës së parë drejtuar udhëheqësve të njësive punuese, si dhe është bërë paraqitja e elaboratit për shërbimin e financave lidhur me blerjen e 19 kutive të ndihmës së parë për të gjitha njësit punuese.

Aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për TM/2, 2018 - Prizren

Në tremujorin e dytë janë realizuar vizita/kontrolli të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje 24 h në pikat e Prizrenit:

- **40 BURIMET**
- **MULLIRI I VJETËR**
- **SHPATI**
- **BUNARI 1**
- **DREJTORIA**
- **KOAGULATORET**
- **FILTRAT**

Në objektin **40 BURIMET** - janë instaluar kamerat ku bëhet monitorim i gjithë objektit 24 h dhe për çdo muaj është pastruar objekti për brenda dhe jashtë tij, roja e këtij objekti i ka dalë në ndihmë një veturë ku e kishte kapluar zjarri dhe me anë të bombolës për shuarjen e zjarrit e kishte fikur makinën që po digjej në afërsi të portës së objektit.

Në objektin **Mulliri i Vjetër** – janë vendosur reflektorët për ta ndriçuar hapësirën për brenda dhe për rreth objektit dhe është bërë mirëmbajtja e objektit dhe oborrit.

Në objektin **Shpati** – është bërë mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë tij.

Në objektin **Bunari 1** – është bërë mirëmbajtja e objektit për brenda dhe jashtë tij, është vendosur kosh mbeturinash, gjithashtu është vendosur edhe një dollap për vendosjen e uniformave dhe gjërave private të rojeve.

Në objekti e **Drejtoria** – është bërë mirëmbajtja e objektit për brenda dhe jashtë tij ku është vendosur edhe një kosh për mbeturina.

Në objektin **Koagulatorët** – është bërë mirëmbajtja e objektit për brenda dhe jashtë tij, është zmadhuar hapësira nga jashtë para objektit edhe për dy vetura më shumë, gjithashtu janë vendosur rrethojat për rreth objektit dhe janë mbuluar me një pëlthurë me ngjyrë gjelbër si shenjë që objekti është me rëndësi të veçantë.

Në objektin **Filtrat** – është bërë pastrimi vetëm në hapësirën e jashtme për shkak se objekti në fjalë është jashtë funksionit.

Vizitat (kontroll) janë zhvilluar edhe në fshatrat për rreth qytetit të Prizrenit si në :

Kushnin të Hasit, Kojush, Gjonaj, Nashec (Sozi), Sërbic, Novak, Zhur, Vërmic.

Janë përpiluar oraret e punës për çdo muaj dhe është bërë shpërndarjen e tyre në të gjitha objektet të cilat kanë kujdestar 24 h në Prizren, po ashtu janë përkrahur, shtypur dhe plastifikuar në format A3 detyrat dhe përgjegjësit e Rojeve në njësinë e Prizrenit.

Malishevë – vizitë objekteve në Drejtorin e Njesisë së Malishevës, Gurbardh, Turjak, Bubël dhe në objektin e fshatit Banjë.

Në të gjitha objektet është bërë mirëmbajtja përbrenda dhe jashtë objektit.

Në objektin e Drejtorisë në Njesisë e Malishevës, ka pas disa problemeve me çatinë e objektit ndërkohë është izoluar çatia dhe i është ndërruar i gjithë pullazi.

Suharekë – vizitë objekteve : në Drejtorin e Njesisë të Suharekës, në rezervuarin e ujit në Samadraxhë, në Baqevc dhe te Pusi i atit në Grejkoc.

Te objekti Pusi i Atit është hapur një burim i ri, për shkak tij është duke u ndërtuar edhe një dhomë shtesë duke ju bashkangjitur objektit të mëparshëm, me qëllim të lokalizohet dhe sigurohet burimi i ujit.

Dragash – vizitë objekteve : në Drejtorin e Njesisë së Dragashit, në objektin e pompave në Brezne dhe në objektin Filtrat në Dragash.

Në objektin “Filtrat” në Dragash janë pastruar filtrat, objekti për brenda dhe për rreth tij, është larguar kontinieri i mbeturinave që ishte vendosur në afërsi të objektit, dhe i gjithë objekti është rrethuar mbi rrethojën që kishte me mbulesë të gjelbër .

Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për prill - qershor 2018

Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

Ndërrhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 49 herë.

Ndërrhyrje në Komune – Malisheve: 31 here

Ndërrhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 76 herë.

Ndërrhyrje në Komune – Suhareke: 66 here.

Ndërrhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 24 herë.

Ndërrhyrje në njësitë Shatërvan: 52 herë.

Ndërrhyrje në njësitë Depo: 15 herë.

Ndërrhyrje në njësinë Filtrat: 87 herë.

Ndërrhyrje në Komunë - Prizren: 100 herë.

Ndërrhyrje në Ueb Faqe 12 herë; Njoftime për konsumatore, gjithsejt 6, ngarkim i dokumenteve (konkurseve) 6.

Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 753 herë.

Përkujdesje për qasjen e Kompanisë në rrjetin e internetit.

Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverëve të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.

Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.

Planifikim i infrastrukturës së mëturjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të Kompanisë.

Riparim harvderik dhe softuerik të pajisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.

Mbikëqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të pajisjeve kompjuterike e pajisjeve të ngjashme teknike.

Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.

Rregullim i Fotokopjes së Suharekës Xerox 5645 nga MIRI XEROX.

Rregullim i Fotokopjes 5655 në Prizren nga MIRI XEROX

Përkujdesje ditore për mbarëvajtjen e shtypjes së faturave.

Përkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve. Serveri Databaze, GIS, DNS.

Përkujdesje për garancionet e pajisjeve dhe dërgimin e pajisjeve të amortizuara për asgjësim në Depo.

Përkujdesje në hapjen e përdoruesve të rinjë në Baze dhe Njësi.

Vendosje e 7 kamerave tek 40 Burimet, shtrirje e kablllove, lidhje, konfigurim, testim.

Përkujdesje për shënimin dhe organizimin e furnizimit të pajisjeve nga furnitori

Konfigurim i modemit të postës.

Ndërrim i VPN-it në Baze.

Ndihme në shtypjen e faturave në Baze dhe njësi.

Rregullim rrjeti në Filtra, (Problem me IPKO).

Rregullim i shtypjes së vërejtjeve në zyrën e shefit të inkasantëve.

Hapje e përdoruesve të rinjë në NAV dhe Billing.

Krijim i PPTP Usereve për kyçjen nga larg.

Marrje e pjesëve funksionale nga Kompjuterët e vjetër (te djegur në pllake), e që ishin të jo funksional dhe pjesët e vjetra i kemi dërgua për ç'regjistrim në Depo. Këtu kemi përfshirë (Printer, Kompjuterë, Ups).

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jenë problem tri lëndët e lartëcekura të cilat e kërcenojnë Kompaninë ku dy lëndë kanë bënë me kontest nga marrëdhënja e punës ndërsa njera me kompensim dëmi.

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç'rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania jonë për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri të përmbarimi i lëndës përmbaruesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbarim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Faturimi në emra të të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbarim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbarimit bien mbi kompaninë.

brenda vitit kalendarik nga konsumatori, ndërsa sa i përket eliminimit të problemit lidhur me konsumatorët e vdekur, ne mendojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte shkyqja nga rrjeti i ujësjellësit. Probleme na paraqesin edhe rastet kur edhe pse konsumatori është shkyqur, faturimi vazhdon, dhe me këtë dëmtohet konsumatori por edhe kompania, sepse në ngarkohemi me TVSH dhe njëkohësisht me veprime të tilla dëmtohet edhe imazhi i kompanisë.

PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM2-2018, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbarim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara;

MASAT E PROPOZUARA

Sipas Zyrës Ligjore për tu zgjidhur problemet e lartcekura, nevojitet angazhim i të gjithë punonjësve dhe në veçanti angazhimi i Inkasantëve pasi që janë në kontakte të rregullta me konsumatorët, ku faktori kryesor përgjegjës për ti ikur parashkrimit të borxheve ndaj kompanisë sonë do të ishte që të njëjtit të detyrohen që të inkasojnë të paktën një pagesë nga borxhi i krijuar

Synim i Departmentit Adminstrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregullorëve të nevojshme për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarvajtjëve të punëve në Kompani si dhe propozimëve të dalura nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja;

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

V. RAPORT I MEDIAVE

PRILL- 2018

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	04.04.2018	Televizioni Opinion	MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK VALDRIN LLUKA VIZITOI PRIZRENIN
2	04.04.2018	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: LLUKA:PRIZRENI DO TË KETË ZHVILLIM EKONOMIK
3	04.04.2018	mzhe-ks.net	ARTIKULLI:LLUKA U PREMTON FSHATRAVE TË PRIZRENIT INVESTIME NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT
4	04.04.2018	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: LLUKA:PRIZRENI DO TË KETË ZHVILLIM EKONOMIK
5	04.04.2018	www.telegrafi.com	ARTIKULLI: LLUKA U PREMTON FSHATRAVE TË PRIZRENIT, INVESTIME NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT
6	04.04.2018	www.kosovapress.com	ARTIKULLI: LLUKA U PREMTON FSHATRAVE TË PRIZRENIT INVESTIME NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT
7	18.04.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË KAMPIN E KFORIT GJERMAN-PRIZREN, PËR SHKAK TË PUNIMEVE
8	18.04.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE TË QYTETIT, PËR SHKAK TË PUNIMEVE
9	18.04.2018	Televizioni Opinion	NË DISA LAGJE TË QYTETIT, TË ENJTEN DO TË KETË REDUKTIME NGA ORA 9 DERI NË ORA 15
10	18.04.2018	RTV - BESA	PUNIMET NË RRJETIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, NESËR NË DISA LAGJE TË QYTETIT, DO TË KETË REDUKTIME TË UJIT
11	30.04.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:AFTËSIMI I SISTEMIT TË UJËSJELLËSIT PËR FSHATRAT:CAPARC,SHPENADI,SMAQ,ETJ.
12	30.04.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA SUHAREKË:PRIETET NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË SHIROKË, PËR SHKAK TË PUNIMEVE
13	30.04.2018	TELEVIZIONI OPINION	AFTËSOHET UJËSJELLËSI PËR FSHATRAT CAPARC, SHPENADI,VELEZHË,TREPETNICË,SMAQ,SËRBICË E EPËRME DHE NOVAKË

14	30.04.2018	RTV-BESA	PËR SHKAK TË PUNIMEVE, DO TË KETË NDËRPRERJE TË UJIT NË SHIROKË TË SUHAREKËS
----	------------	----------	--

MAJ- 2018

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	03.05.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: REDUKTIME TË UJIT NË FSHATIN VLASHNJE, PËR SHKAK TË RRRITJES SË KONSUMIT TË UJIT DHE KEQPËRDORIMEVE
2	03.05.2018	RTV-BESA	PËR SHKAK TË KEQPËRDORIMIT TË UJIT TË PIJES, DY LAGJE NË FSHATIN VLASHNJE MBESIN PA UJË
3	08.05.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E FURNIZIMIT ME UJË NË QYTETIN E PRIZRENIT, PËR SHKAK TË PARAQITJES SË DEFEKTIT
4	08.05.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA SUHAREKË: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË LAGJEN SHIROKË PËR SHKAK TË NDËRRIMIT TË RRJETIT TË UJËSJELLËSIT
5	15.05.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: AFTËSIMI I SISTEMIT TË UJËSJELLËSIT PËR FSHATRAT: CAPARC, SHPINADI, VELEZHË, etj.
6	15.05.2018	TELEVIZIONI OPINION	KRU-"HIDROREGJIONI JUGOR" PRIZREN, NJOFTON SE, PAS NJË PUNE INTENSIVE, KA ARRITUR TË AFTËSOJË SISTEMIN E UJËSJELLËSIT PËR DISA FSHATRA
7	16.05.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA, PËR SHKAK TË PUNIMEVE NGA KEDS--i.
8	26.05.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA SUHAREKË: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA TË SUHAREKËS, PËR SHKAK TË NDËRPRERJEVE TË PLANIFIKUARA NGA KEDS-i.

QERSHOR- 2018

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	13.06.2018	KLAN KOSOVA	KFW, GRANTE TË REJA PËR UJËRAT
2	13.06.2018	EKONOMIA ONLINE	ARTIKULLI: KFW JEP 8 MILIONË EURO PËR MËNJANIMIN E UJËRAVE TË ZEZA NË PRIZREN, PEJË DHE GJAKOVË
3	13.06.2018	www.telegrafi.com	ARTIKULLI: GJERMANIA JEP GRANT PËR MËNJANIMIN E UJËRAVE TË ZEZA
4	14.06.2018	EKONOMIA ONLINE	ARTIKULLI: RESHITAJ VIZITON "HIDROREGJIONIN JUGOR", PREMTON INVESTIME NË UJËSJELLËS DHE TRAJTIM TË UJËRAVE TË ZEZA
5	22.06.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË PRIZREN NË KUADËR TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT TË GYPSJELLËSIT TË QYTETIT
6	27.06.2018	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE , PËR SHKAK TË PARAQITJES SË DEFEKTIT

VI. RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezentimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të cilat janë realizuar gjatë tremujorit të dytë të këtij viti, gjegjësisht raport i punës për periudhën kohore prill – qershor 2017.

Në pajtim me planin vjetor të punës për vitin 2017, i aprovuar nga Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2016, janë realizuar disa auditime, sikurse:

- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të raportimit,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesimit të lëndëve gjyqësore,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të prokurimit, si dhe
- Auditimi lidhur me menaxhimin e planit të biznesit të kompanisë.

Gjatë kësaj periudhe, është punuar gjithashtu rreth:

- Përgatitjes së raportit tremujor për periudhën TM1,
- Në bashkëpunim me zyrtarë tjerë është shqyrtuar letra e ARRU-së, lidhur me caqet e realizimit,
- Përgatitja e materialit lidhur me projektin e CDI-së të kërkuar nga auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, gjithashtu edhe takime me auditorët në fjalë,
- Përgatitja e materialit për Auditorin e Jashtëm, gjatë auditimit të pasqyrave financiare të kompanisë për vitin 2016,
- Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, konkretisht gjatë muajit qershor kam shfrytëzuar pushimin vjetor, të vitit ta kaluar.

Sa i përket auditimeve, pas përfundimit të tyre, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë: përgatitja e draftraporteve dhe rporteve finale, mbajtja e takimeve me udhëheqësit e subjekteve të audituara, si dhe diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve.

Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimeve të kësaj periudhe tremujore, edhe përkundër që në disa procese janë konstatuar edhe mangësi, ku dhe janë dhënë rekomandime të cilat edhe priten të realizohen, në përgjithësi, është konstatuar se menaxhimi i proceseve dhe zhvillimi i procedurave, janë kryer në pajtim me dispozitat ligjore, është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, është bërë rishikimi i rekomandimeve të dhëna gjatë tremujorit të parë të punës, ku edhe pse numri i tyre ka qenë i vogël dhe i një rreziku jo të lartë, megjithatë është konstatuar se adresimi i tyre është në nivel të mirë, me çrast shumica e tyre është realizuar.

VII. E CURIT E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT TM2 - 2018

1)Titulli I kontratës:

Matja e kënaqmerise së konsumatorëve me numër Prokurimi
HJ-18-001-236

- a)Nga KE është dërguar inicimi me datë 22.01.2018 .
- b)Me date 05.02.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 05.02.2018 është aprovuar qe të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c)Kontrata është nënshkruar me datë 05.03.2018 me numër protokoli 381 me operatorin ekonomik N.SH."D&D Business Suport-Center"
- d)Qmimi I total I kontratës është 1,911.00 €.
- e)Afati I perfundimit të sherbimit me 22.03.2018.
- f)Kontrata ka përfunduar me datë 29.03.2018.

2)Titulli I Kontratës:

Vlerësimi I rrezikut për sigurinë dhe shëndetin në punë me numër Prokurimi
HJ-18-002-221

- a)Nga KE është dërguar inicimi me datë 21.11.2017 .
- b)Me datë 15.01.2017 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 16.03.2018 është aprovuar qe të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c)Kontrata është nënshkruar me datë 25.04.2018 me numër protokoli 715 me operatorin ekonomik H.S.K L.L.C .
- d)Qmimi I total I kontratës është 10,349.00 €.
- e)Afati I perfundimit të sherbimit me 24.05.2018.
- f)Kontrata ka përfunduar me datë 29.05.2018

3) Titulli I Kontratës:

Shpallje në media me numër Prokurimi

HJ-18-003-221

- a) Nga KE është dërguar inicimi me datë 22.01.2018
- b) Me datë 08.02.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 16.02.2018 është aprovuar që të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c) Kontrata është nënshkruar me datë 10.04.2018 me operatorët ekonomik :
- Lot I .: Televizioni local Prizren “OPINION”
- Lot IV: Radio Lokale ne Gjuhën Shqipe “Helix”
- Lot V: Radio Lokale Ne Gjuhën Boshnjake “OMEGA”
- d) Qmimi I total : Lot I .: Televizioni local Prizren “OPINION” është 2,400.00 €
- Lot IV: Radio Lokale ne Gjuhën Shqipe “Helix” është 600.00 €
- Lot V: Radio Lokale Ne Gjuhën Boshnjake “OMEGA” është 600.00 €
- e) Afati I perfundimit të shërbimit me 09.04.2019.
- f) Kontrata Aktive.

Me datë 28.03.2018 bëhet njoftimi për anulimin e aktiviteteve për Lot II, Lot III, Lot VI, Lot VII, Lot VIII, Lot IX.

3) RITENDER: Shpallje në media me numër Prokurimi (Lot II, Lot III, Lot VI, Lot VII, Lot VIII, Lot IX).

HJ-18-003-221

- a) Me datë 11.05.2018 është bërë Njoftimi për kontratë.
- b) Dorëzimi I ofertave me datë 18.06.2018
- c) Nënshkruhen kontratat me datë 11.07.2018.
- 1) LOT II “Televizioni Besa “ me vlere prej 2,400.00 €
- 2) LOT III “Televizioni Prizreni” me vlere prej 2,400.00 €
- 3) LOT VI “Media center Vala” me vlere prej 655.00 €
- 4) Lot VII “Radio locale Malisheve” me vlere prej 600.00 €
- 5) LOT IX N.G.B “Zeri “ SHPK me vlere prej 1,125.00 €

4) Titulli I Kontratës:

Furnizim me karburant me numër Prokurimi

HJ-18-004-111

a) Nga KE është dërguar inicimi me datë 22.01.2018.

- b)Me datë 12.02.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe është aprovuar qe të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c)Kontrata është nënshkruar me datë 25.05..2018 me operatorin ekonomik “Petrol Compani”
- d)Qmimi I parashikuar është për tri vite 330,750.00 € Premium kontrata fitohet me 31.50 €(Premium)
- e)Afati I perfundimit të furnizimit me 09.05.2021.
- f)Kontrata është active.

5) Titulli I Kontratës:

Furnizim me pompë dozuese me numër Prokurimi
HJ-18-005-136

- a)Nga KE është dërguar inicimi me datë 22.01.2018 .
- b)Me datë 06.02.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 03.03.2018 është aprovuar qe të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c)Kontrata është nënshkruar me datë 17.04.2018 me numër protokoli 627 me operatorin ekonomik N.P.T “Avesta”
- d)Qmimi I total I kontratës është 5,400.00 €.
- e)Afati I perfundimit të furnizimit është me 17.05.2018.
- f)Kontrata ka përfunduar .

6) Titulli I Kontratës:

Furnizim me artikuj ushqimor me numër Prokurimi
HJ-18-006-121

- a)Nga KE është dërguar inicimi me datë 22.01.2018
- b)Me date 09.03.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 05.04.2018 është aprovuar qe të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- d)Kanë ofertuar tri firma.
- c)Kontrata është anuluar për shkak se operatorët ekonomik kanë qenë të papërgjegjshëm.
- d)Me datë 25.04.2018 bëhet anulimi I procedurës të këtij aktiviteti.

7) Titulli I Kontratës:

Furnizim me pjesë të ujëmatësave me numër Prokurimi
HJ-18-007-121

- a) Nga KE është dërguar inicimi me datë 22.01.2018
- b) Me datë 27.03.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 03.03.2018 është aprovuar që të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c) Me datë 30.04.2018 është bërë dorëzimi I ofertave.
- c) Kontrata është nënshkruar me datë 11.06.2018 me numër protokoli 1200 me operatorin ekonomik D.P.T “Endriti”
- d) Qmimi I total I kontratës është 24,729.50 €.
- e) Afati I perfundimit të furnizimit është me 10.06.2020, kjo kontratë është dy vjeqare.
- f) Kontrata aktive .

8) Titulli I Kontratës:

Furnizim me pjese fazonike nën 2 col me numër Prokurimi
HJ-18-008-111

- a) Nga KE është dërguar inicimi me datë 23.03.2018
- b) Me datë 29.03.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 29.03.2018 është aprovuar që të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c) Me datë 30.04.2018 është bërë Njofimi për kontratë.
- e) Dorëzimi I ofertave është më datë 27.06.2018
- f) Ky aktivitet është ende në procedurën e vlerësimit.

9) Titulli I Kontratës:

Furnizim me automjete me numër Prokurimi
HJ-18-009-111

- a) Nga KE është dërguar inicimi me datë 05.03.2018
- b) Me datë 18.04.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë 19.04.2018 është aprovuar që të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c) Me datë 27.04.2018 është bërë Njofimi për kontratë.
- e) Dorëzimi I ofertave është më datë 14.06.2018
- f) Anulohet kontrata.

10) Titulli I Kontratës:

Servisimi I automjeteve
HJ-18-010-236

- a)Nga KE është dërguar inicimi me datë 12.02.2018
- b)Me datë 30.04.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit .
- c)Me datë 14.06.2018 është bërë Njofimi për kontratë.
- e)Dorëzimi I ofertave është më datë 28.06.2018
- f)Kontrata nënshkruhet me datë 09.07.2018 Me operatorin ekonomik “Krasniqi” ne vlere prej 5,511.00 €.

Këto kontrata janë të vitit 2017 por janë nëshkruar në vitin 2018

1)Titulli I kontratës:

Renovimi I kulmit te objektit dhe mbulimi I garazhave tek njesia punuese ne Malisheve me numër
Prokurimi
HJ-17-025-521

- a)Nga KE është dërguar inicimi me datë 06.10.2017.
- b)Me datë 06.11.2018 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe është aprovuar qe të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c)Me datë 13.11.2017 është bërë Njofimi për kontratë.
- e)Dorëzimi I ofertave me datë 15.12.2017.
- f)Kontrata është nënshkruar me datë 26.01.2018 me numër protokoli 147 me operatorin ekonomik SH.P.K “Hidro Projekt”
- h)Qmimi total I punëve është me vlerë prej 9,890.00 €.
- j)Me datë 27.04.2018 është aprovuar nga KE punët shtesë me vlerë prej 943.00 €
- K)Totali I punëve të kësaj kontrata ka arritur vlerën 10,833.00 €
- g)Pranimi teknik me datë 02.05.2018 me numër protokoli 47/2018.

2)Titulli I kontratës:

Furnizim me GPS me numër Prokurimi
HJ-17-009-121

- a)Nga KE është dërguar inicimi me datë 04.07.2017 .

- b) Me datë 04.08.2017 është dorëzuar në zyrën e Prokurimit dhe me datë është aprovuar që të vazhdohet me këtë aktivitet nga Komisioni I Auditimit.
- c) Me datë 09.08.2018 është bërë Njofimi për kontratë.
- e) Dorëzimi I ofertave më 31.10.2017
- f) Kontrata është nënshkruar me datë 13.04.2018
- g) Pranimi teknik me datë 24.04.2018 me numër protokoli 47/2018.

- 10) Në zyrën e Prokurimit janë të dorëzuara edhe dy inicime me paramssa të tendere ku ende nuk e kemi aprovimin për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshëm të Prokurimit.
- Me datë 21.02.2018 është dërguar deklarata për tenderin me titull :”Furnizim me material për zyre” në imel tek Komisioni i Auditimit dhe nuk është ende aprovuar.
- Me datë 17.04.2018 është bërë edhe një riikujtim për procedure me titull “Furnizim me material për zyre” ende nuk kemi përgjigje.
- Me datë 30.04.2018 është dërguar deklarata për iniciimin e tenderit me titull”Furnizim me goma për automjete,ende nuk është aprovuar nga komisioni I auditimit.

ANEKS.1

Shpenzimet e tjera

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Shpenzimet Prizren	Shpenzimet Suharekë	Shpenzimet Dragash	Shpenzimet Malishevë	Totali i shpenzimeve
1	Materiale te prodhimit					-
2	<i>Udhëtime zyrtare-regj.</i>	2,282.39				2,282.39
3	Shpenz. per udhet. per punetor pz.					-
4	Shpenzimet e medijëve	1,523.40				
5	Material shpen.të administratës	300.20	15.17	7.29		322.66
6	Shpenzimet per ushqim te puntoreve	654.25			40.34	694.59
7	Shpenz. e hulumtimit arkeologjik					-
8	Shpenz.e trajnimit dhe konferanca					-
9	Shpenz. e trajn. dhe mbrojtjes ne pune					
10	Shpenz. Reklamave	450.00				450.00
11	Shpenzime tjera jo materiale	538.25		16.95		555.20
12	Telefon - PTK-së	99.31	9.30	17.36	8.36	134.33
13	Telefon - PTK-së (mobil)	1,107.62	161.63	47.54	152.12	1,468.91
14	Shpenz. per perlqim MMPH					
15	Përfaqësimi regj.	605.47	80.00			685.47
16	Shpenzimet e internetit	259.43				259.43
17	Shpenzimet solidare					-
18	Shpenzime te kamates	67.11				67.11
19	Shpenz. e kamates se vetures					-
20	Shpenzimet solidare					-
21	<i>Provizioni-Pz</i>	125.00				125.00
22	<i>Provizioni</i>	24.90				24.90
23	<i>Shpenzimet e qerase</i>	1,381.09				1,381.09
	<i>Amortizimi mujor sipas 2017</i>					
	TOTALI	Prizren	Suharekë	Dragash	Malishevë	Gjithsej shpenzimet
		9,418.42	266.10	89.14	200.82	9,974.48

ANEKS.2

Aktivitetet e Projektit te Ujërave të Zeza - Prill-Qershor, 2018

Faza e pare I e projektit

“Ndertimi i Kolektorit Kryesor”

Per ecurine e aktiviteve dhe progresit te punimeve per Fazen 1 “Ndertimi kolektorit kryesor” jeni njoftuar permes Raporteve mujore gjate vitit 2016 dhe 2017, me qe kjo Faze ka perfunduar ne raportin e muajit te fundit te vitit 2017 po ju njoftojme me obligimet e ndersjellta ne mes te KRU”HRJ”-se dhe Kontraktorit PASSAVANTE & KWE ne lidhje me Fazen 1 te projektit:

Projekti ka perfunduar conform kontrates, Periudha e komisionimit eshte 12 muaj pas perfundimit te projektit dhe nenkupton qe brenda kesaje periudhe munde te kete defekte eventuale ne project, me crast kontraktori eshte i obliguar qe brenda kesaje periudhe ti sanoje te gjitha defektet ose problemet ne kete project ne te kunderten nuk do ti paguhet pagesea e cila i eshte mbajtur ne cdo situacion te pagesave me nje perqindje prej 5% te vleres. Pagesa per fazen 1 te ketije projekti eshte kryer plotesisht ne perjashtim te nje pjese e cila eshte mbajtur per gjate implemtimit te projektit, kjo pagese qe kap vleren rreth 115,000.00 euro do te paguhet pasi qe te perfundoj afati i komisionimit i cili sipas kontrates eshte 12 muaj, kjo pagese do te realizohet tek kontraktori ne momentin kur do te perfundoj periudha e komisionimit diku kah muaji shtator 2018.

Per te dhena tjera ne lidhje me fazen 1 te projektit kemi ne dispozicion Raportin Periodik te perpiluar nga Konsulenca P2m dhe Alb Architect, si dhe nga kryetari i komitetit te ketije projekti Lulzim Paçarizi.

Faza e dyte II e projektit:

“Dizajnimi dhe ndertimi i Impiantit per trajtimin e ujerave te zeza”

- Projekti ka të bëjë me dizajnimin dhe ndërtimin e ITUZ-së, per realizimin e ketij projekti me date: 05.05.2015 eshte nenshkruar kontrata ne mes te kompanise AQUALIA nga Spanja si dhe KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh.A, vlere e kontrates eshte 10,354,512.41 EUR .

Sipas marrevshjes kontraktuale per kete porjket duhet te paguhet avanci me vlere prej 20% e vleres se kontrates, pagese te cilen duhet ta paguaj MMPH.

-Deri me tani konform marrevshjes speciale te reviduar nga ana e kontributit vendor jane paguar ne emer te avancit per Fazen II, 625,000.00 Euro kurse pjesa e mbetur duhet paguar nga KfW.

Bazuar ne Marrevshjen e vecant ne te cilen eshte qartësuar planifikimi i mjeteve per kontributin vendor dhe kontributin e jashtem, eshte riplanifikuar buxheti i kontributit vendor ku dhe sipas minutave te takimit te dates 14 Tetor 2015 te nenshkruar nga MMPH, Komuna e Prizrenit, HRJ dhe KfW eshte parapare:

